



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.37, datë 20.11.2025

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
FIER SH.A.**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (*Ligji nr. 8102*), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (*VKM nr.958*), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (*Rregullore e licencimit*),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

Në mbledhjen e datës 20.11.2025 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.",

Konstaton se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a shkresës me nr. 1322 prot, datë 01.08.2025 me lëndë "Plotësim dokumentacioni", shkresës me nr. 1450 prot, datë 21.08.2025, me lëndë "Plotësim dokumentacioni", shkresës me nr. 1532/1 prot, datë 08.09.2025, me lëndë "Plotësim dokumentacioni" dhe shkresën me nr. 2137 datë 18.11.2025 me lëndë "Kërkesë me rinovim licence", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (*ERRU*) kërkesën për licencim.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (*KKRR*) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (*VKM nr. 302*).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a me (NUIS M23315402G) është themeluar më datë 08.09.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe Bashkitë Fier me 33.99 %, Patos me 5.21 %, Roskovec me 4.31 % dhe Mallakastër me 5.49 %;
- b) Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 225 721 banorë të Bashkive Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër;
- c) Drejtues ligjor i shoqërisë z. Klodjan Mema zotëron Diplomë të Nivelit të Dytë si Jurist, viti 2010 si dhe diplomë Master Profesional “E drejta publike”, viti 2012 në Universitetin Justiniani 1, Fakulteti i Drejtësisë;
- d) Drejtues teknik i shoqërisë z. Artur Baxhia është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave në vitin 1995 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë Rajonale UK Fier detyron:

- a) Shoqërinë Rajonale UK Fier, të pajiset me akt miratimet higjieno - sanitare të njësisë së ujësjiellës Bashkia Patos.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a me (NUIS M23315402G), në kategoritë:

- a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;
2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
- a) Drejtues Ligjor – z. Klodjan Mema
 - b) Drejtues Teknik – z. Artur Baxhia
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a janë Bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

GERTA LUBONJA